

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mustafa: Jam takuar me Kurtin për ta diskutuar platformën time për zhblokimin institucional
ADRESA	https://www.koha.net/arberi/mustafa-i-pdk-se-shpreh-bindjen-se-thaci-do-te-mund-te-bashk-eqeveriste-me-kurtin
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 01:37:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 21:21:53 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5e6846c9532c0b4ed39e633ec5b3424c9245377cad8144b1d8d7d4f56d8176e8
TEKSTI	ab57e1cad71462d25728beab7d52c02899515bcbaabf18a36e19209744e5b19
PAMJA	8986a02f3bead1d94beeab4743e7109baed23e18a9fc12084e9a3d6bb1ba4d6d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6ce4addd0a51a985cb695c17eefa21d681b7e7713beaad90594749efd08eaa43
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	339a441950953cdd8a76a2c095ab2238d5bab62fcc252abcef1242a6a5fba2fb
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6ce4addd0a51a985cb695c17eefa21d681b7e7713beaad90594749efd08eaa43>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën

Kontribuo →

Letër lexuesit

ARBËRI

Mustafa: Jam takuar me Kurtin për ta diskutuar platformën time për zhbllokimin institucional



14 shtator 2026 23:21

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalim tonë zyrtar në Viber

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Rustem Mustafa, ka thënë se është takuar me kryeministrin e Kosovës dhe kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, për ta diskutuar platformën e tij.

Mustafa ka propozuar një "Koalicion të Normalitetit" mes Lëvizjes Vetëvendosje, PDK-së dhe komuniteteve joshumicë.

Mustafa në "Interkativ" të KTV-së ka thënë se me Kurtin është takuar në ditët e fundit.

"Personalisht kam pasur takim të rëndësishëm, të gjatë e të frytshëm me kryetarin e Vetëvendosjes, Albin Kurti, ditëve të fundit. Krejt lidhur me platformën që kam shpalosur. Ndoshta jo të gjitha detajet që sot lexohen", ka thënë Mustafa.

Ai ka thënë se kanë nisur negociatat dhe ka nisur njohja me idenë e tij. E ai pret që ditët në vazhdim t'i jepet mundësia për këtë marrëveshje.

Edhe



Arbëri • 2 o. më parë

Mustafa propozon "Koalicion për Normalitet" mes VV-së, PDK-së dhe komuniteteve joshumicë

Ai ka thënë se mundësia më e mirë për një marrëveshje koalicioni është mes Vetëvendosjes dhe PDK-së.

Në platformën që Mustafa e shpalosi në Facebook të hënën, ka propozuar që presidenti t'i takojë Partisë Demokratike të Kosovës, ndërsa posti i kryeministrit dhe Kuvendi t'i takojnë Vetëvendosjes.

PDK-ja ka dërguar të hënën në Gjykatën Kushtetuese, konstituimin e Kuvendit të Kosovës, ndërsa pritet ta dërgojë të martën në Kushtetuese edhe zgjedhjen e Qeverisë Kurti 4.

"Politika është instrumenti më i rëndësishëm i një vendi. Unë po thërras instrumentin politik me nëndor nër të mirë. Dëshimi që të

Arbëri.

Mustafa: Jam takuar me Kurtin për ta diskutuar platformën time për zhbllokimin institucional

Futboll.

Newcastle pëson debakël nga Leeds

Futboll.

Spektakël në Serie A, Interi fiton 5:3 ndaj Udineses

Futboll.

Kosova i luan 4 ndeshje brenda 16 ditësh grumbullim

Arbëri.

VV-ja pas tërheqjes së Sejdiut: Ishte mundësia që çështja e presidentit të zgjidhej, por u bllokua sërish

LAJMET E MBRËMJES.

Mbrojtja kërkon lirin e Thaçit e katër të tjerëve në rastin për pengim të drejtësisë

jep Kushtetuesja, nuk e heq instrumentin politik prej rendit të ditës...Nuk e hjek mundësinë për takime e thirrje të tryezës nga kryeministri Albin Kurti për t'u ulur e të bisedohet gjerë e gjatë për mënyrën si të ecim e të dalim nga ky ngërç", tha Mustafa.

Ai ka thënë se Kurti e ka pritur mirë dhe ka pasur takim të gjatë.

"Ka qenë takim i kënaqëshëm si takim i parë. Pres që z. Kurti ta bëjë ftesën e radhës. Të më ftoj mua e të merremi vesh si të lëvizim tutje", tha Mustafa.

Mustafa i PDK-së shpreh bindjen se Thaçi do të mund të bashkëqeveriste me Kurtin

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Rrustem Mustafa, ka thënë se edhe ish-presidenti i Kosovës dhe ish-kreu i PDK-së, Hashim Thaçi, do ta përkrahte platformën e tij për një koalicion PDK – Vetëvendosje.

Edhe



Arbëri • 24 gus 2026

Mustafa: VV – PDK munden bashkë

Mustafa në "Interaktiv" ka thënë se beson te një verdikt pozitiv për ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që po gjykohej në Hagë. Verdicti për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin e Jakup Krasniqit do të jepet më 16 shtator.

"S'ka pasur asnjë moment kur z. Thaçi nuk është integruar në zhvillimet pozitive të vendit. Besoj do të jetë mbështes i madh i platformës e do të ndihmojë të ecim tutje. Kemi pasur edhe raste tjera që kemi kaluar. Ju kujtohet pas luftës, kam folur edhe kam qenë për koalicionin e madh PDK – LDK. Kur askush nuk besonte unë gjithë e kam pasur mendimin aty. E kam pas dhënë si provim të parë, kur kemi bërë koalicion me z. Lutfi Haziri në Gjilan. E di se çfarë fjalë ka pasur e çfarë zhvillimesh. Nisën të zbuteshin gjakrat. E di që koalicioni me LDK ka qenë i madh e ka sjellë rezultate të mira për vendin e kemi shtensionuar situatën", tha Mustafa.

Mustafa ka thënë se është i sigurt që Hashim Thaçi e Albin Kurti do të mund të bashkëqeverisin.

"Jam i sigurt që z. Thaçi e z. Kurti do të bashkëqeverisin. Kam bindjen që ky koalicion do të sillte stabilitet e mirëqenien shumë të mirë për njerëzit. Është në dorën e kryeministrit Albin Kurti për të bashkëpunuar e për të mos shkuar në zgjedhje", tha Mustafa.

Mustafa: Një koalicion mes PDK-së dhe VV-së mund të normalizojë vendin

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Rrustem Mustafa insiston se një koalicion mes PDK-së dhe Lëvizjes Vetëvendosje do të mund ta normalizonte vendin. Ai ka thënë se këto dy subjekte politike, bashkë me pjesën e deputetëve joshumicë, do të mund të zgjidhnin të gjitha ngërçet.

Në emisionin "Interaktiv" në KTV, Mustafa është shprehur se ai e quan koalicionin për normalitet dhe se bashkë do të krijojnë udhëheqje të mirë qeveritare.

"Koalicioni për normalitet që e them unë lë hapësirë për të diskutuar edhe për koalicion edhe më të gjerë. Janë numrat e mjaftueshëm bashkë me komunitetet joshumicë për të zgjedhur çështjet e duhura dhe për të krijuar normalitet. Unë e di që PDK-ja dhe Kurti me Vetëvendosjen mund ta normalizojnë vendin dhe mund të krijojnë trupa të mirë qeveritarë bashkë, edhe presidentin për të pasur zhvillime të mira të ecjes së vendit", ka thënë Mustafa.

Edhe



Arbëri • 11 gus 2026

Deputeti i PDK-së bën thirrje për koalicion me VV-në: Domosdoshmëri shtetërore

Thirrjen për një koalicion të tillë Mustafa e ka thënë tash e disa herë. Ai u ka bërë thirrje drejtpërdrejt kryetarit të PDK-së, Bedri Hamza dhe liderit të LVV-së, Albin Kurti, që të takohen dhe të diskutojnë për një marrëveshje.

Ndërkohë, PDK-ja është e vendosur të mbetet në opozitë derisa Kurti i ka bërë ftesë në vazhdimësi për takim.

#RRUSTEM MUSTAFA

Artikuj të ngjashëm

LAJMET E MBRËMJES • 9 sht 2026

Kurti kërkon takim me Hamzën e Abdixhikun për nënkryetarët e Kuvendit

Arbëri • 5 sht 2026

Hamza: PDK-ja do të veprojë që ligjshmëria të rikthehet

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.